



Primar / Dorezuar Pamirëno / Proradato Received / Delivered		13-07-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Hi Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	4078/2022		1/3	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.494/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.494/2022 të datës 02.06.2022 të parashtruar nga ankuesja

undër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike “*kërkese nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 13.07.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.494/2022 e datës 02.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja nëpunëse civile në Policinë e Kosovës, më datë 02.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3213/2022 nën shenjën A.nr.494/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 28.04.2022 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, me pretendim se ky njoftim përmban shkelje procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Policinë e Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 29.06.2022 ka dërguar vetëm shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3213/2022 të datës 02.06.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 04.05.2022 nga për Emalin e datës 29.04.2022 nga për Emalin e datës 28.04.2022 nga për Vendimin DDBN-7.0002021 të datës 05.05.2021 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Disiplinore për nëpunësit e Shërbimit Civil; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3341/2022 të datës 08.06.2022; Përgjigjen me numër të protokollit 3795/2022 të datës 29.06.2022; Kontratën e punës me Nr. Referencës PK/DP/NRS/0385/12; Emalin e datës 05.05.2021 nga për Emilin e datës 29.04.2021 nga për Emalin e datës 23.04.2021 nga për Shkresën mjekësorë të datës 22.04.2021; Emalin e datës 22.06.2022 nga për Emailin e datës 15.06.2022 nga për Emalin e datës 04.05.2022 nga per Emalin e datës 28.04.2022 nga për Emalin e datës 22.06.2022 nga për Emalin e datës 15.06.2022 nga për Emalin e datës 04.05.2022 nga per Emalin e datës 25.05.2022 nga për Emalin e datës 24.05.2022 nga per Emailin 04.05.2022 nga per Emalin e datës 29.04.2022 nga për Vendimin DDBN-07/013/2022 të datës 11.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështje juridike, kontestoi se ankesa e ankueses është e pajueshme, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Kontratës së Punës Nr. Reference: PK/DP/NRS/0385/12 të nënshkruar me datë 02.05.2012 është emëruar në pozitën "Zyrtare e Lartë Ligjore", Njësia për menaxhim të kontratave dhe hulumtim të tregut në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës. E njëjta me Vendimin DDBN-07-095-2021 të datë 05.05.2021 të Drejtorit Departamentit të Burimeve Njerëzore është caktuar anëtare e Komisionit Disiplinore si zëvendësuese e anëtares

Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore përmes emailit të datës 28.04.2022 ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës aprovimin lidhur me shkarkimin e të gjithë anëtareve të Komisionit Disiplinore në Policinë e Kosovës respektivisht Kryesuesit si dhe anëtarëve dhe me arsyetimin se ky Komision ka treguar performancë të ulët, bashkëpunim jo të mirë me komisionet e tjera për disiplinë si dhe mungesë të vendimmarrjes sidomos të rastet kur zyrtaret dyshohet se kanë kryer vepër penale, si dhe mos trajtim apo shpallja jo kompetent për një numër të konsiderueshëm të rasteve.

Bazuar në aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës të datës 29.04.2022, me Vendimin me numër DDBN-07/013/2022 të datës 11.05.2022 është themeluar Komisioni Disiplinor për nëpunësit e shërbimit civil në Policinë e Kosovës ndërsa në pikën II të këtij vendimi janë shfuqizuar Vendimi me numër DDBN-07/002/2021 të datë 09.02.2021 dhe Vendimi me numër DDBN-07-095-2021 të datë 05.05.2021.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 28.04.2022 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore,



me pretendim se ky njoftim përmban shkelje procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me veprimin e kundërshtuar me ankesë gjegjësisht njoftimin e datës 28.04.2022 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore lidhur me shkarkimin e të gjithë anëtareve të Komisionit Disiplinore në Policinë e Kosovës nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës rrjedhimisht ankuesja nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridike, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.494/2022 e datës 02.06.2022, e parashtruar nga ankuesja është e papranueshme.

Siç u vërtetua me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.494/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

*[Signature]*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

